



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:006412

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05997253

Ac.nr.534/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.S.F nga fshati ... Komuna Kaçanik, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.K.B avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut, të cilën me autorizim e përfaqëson Ilir Lumi, për çështjen kontestuese kompenzimi i palujtshmërisë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit e Gjykatës Themelore Ferizaj - Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.151/15, i datës 08.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Kaçanikut, ndërsa aktgjykimit e Gjykatës Themelore Ferizaj - Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.151/15, i datës 08.09.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar Cn.nr.151/15, i datës 08.09.2020, ka vendosur në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A.S.F nga fshati ... Komuna Kaçanik dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Kaçanikut, që paditësit të i'a paguaj shumën prej 3,765.00€, në emer të kompenzimit për pronën e përvetësuar dhe për prerjen e drunjëve në ngastrën kadasrale ..., e evidentuar në çertifikatën e pronës me numër të landës ... edhe ate:

-Për pjesën e ngastrës ..., në sipërfaqe prej 419 m² x 7, 00 € = në shumë prej 2.933.00€ dhe vlerën e trungjeve 105x 0.088m=924m³ x 90.00€/m³= e në shumë prej 3832.00€.

Këtë shumë me kamatë prej 8% duke filluar prej datës 02.09.2020, (data e séances kryesore), e deri ne pagesën definitive.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit të këtijë aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,246.86 €, të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta prish aktgjykimin e goditur dhe të hedhë poshtë kërkesëpadinë apo të prishet aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesën e të paditurës, nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se propozuesi përmes të autorizuarës të tij, me datë 09.09.2015 ka paraqitur padi për kompensimin e paluajtshmërisë, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, deklarimit të palëve në procedurë, fillimisht ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.151/15, i datës 08.09.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimin e propozuesit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ngastra kontestuese është pronë e paditësit ku këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga certifikata e pronësisë me numër ..., në të cilën është shënuar se ngastra kadastrale ..., është pronë e A.F nga fshati ..., ky fakt nuk ishte kontestues në mes palëve ndërgjyqëse dhe vërtetoi se e paditura po ashtu me rastin e zgjerimit, ndërtimit dhe asfaltimit të rrugës, e ka bërë edhe prerjen e drunjëve, ku ka konstatuar se janë dëmtuar 105 trungje me diametër 14cm, të llojit bung/qarr, të mosha 35 vjeçare, boniteti i klasës së dytë, në fazën e rritjes dhe është dëmtuar sipërfaqja prej 419 m², e që sipas llogaritjes nga rezulton se dëmi arrinë në shumë prej 832 €. Dëmi është shkaktuar me fajin e të paditurës ku është theksuar se e paditura gjatë viteve 2014-2015 dhe 2016, e ka bërë zgjerimin, ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës së fshatit

Me turje ka shtuar se, e paditura gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, e ka bërë zgjerimin-ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës së fshatit ... dhe gjatë zgjerimit të rrugës e ka përvetësuar një pjesë të pronës së paditësit, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë M.S, i cili ka konstatuar se është marrë sipërfaqja prej 419 m² nga ngastra kadastrale ... pronë

e paditësit, Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga theksimet e të autorizuarit të paditësit i cili ka theksuar se Komuna e Kaçanikut e ka bërë zgjerimin e kësaj rruge dhe asfaltimin por pa i zhvilluar procedurat e parapara me ligj.

Baza ligjore që e paditura të jetë përgjegjëse për kompensimin e dëmit, gjykata e ka bazuar në nenin 136 i LMD-së, pasi që rastin konkret e paditura paditësit ia ka shkaktuar dëmin me veprimet e sajë gjatë zgjerimit dhe asfaltimit të rrugës.

Paditësi këtë dëm e ka pësuar pa fajin e tij dhe me fajin e të paditurës, sepse e njëjta pa kurrfarë procedure e ka marrë një pjesë të pronës së paditësit. Të gjitha këto fakte janë vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se e paditura gjatë ndërtimit dhe asfaltimit të rrugës paditësit ia ka marrë sipërfaqja prej 419 m², nga ngastra ... ZK ... të evidentuar në certifikatën e pronës me numër

Gjykata po ashtu i analizoi pretendimet e të paditurës, i cili i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë ta refuzojë në tersi si të pa bazuar ku gjykata këto pretendime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar me veprimet e të paditurës gjatë zgjerimit dhe asfaltimit të rrugës së fshatit ... gjatë vitit 2014-2016. Tutje gjykata i ka analizuar dhe pretendimet e palës së paditur, i cili ka theksuar se kërkesa e paditësit është parashkruar, por këto pretendime nuk i mori për bazë për arsye se e paditura dëmin e ka shkaktuar gjatë vitit 2014-2016, ndërsa paditësi padinë në gjykata e ka dorëzuar më datën 09.09.2015, pra në afatin e paraparë ligjor.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata e ka bazuar në dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilat për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë si dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e të paditurës janë të pa specifikuar në drejtim të shkeljeve qoftë të aspektit procedural, gjendjes faktike apo zbatimit të së drejtës materiale. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pasi në raport me identifikimin e sipërfaqes dhe ngastrës lëndore është vërtetuar me

ekspertizë të gjeodezisë nga eksperti M.S ekspertiza e datës 13.05.2019, ndërsa për dëmtimin e trungjeve është vërtetuar me ekspertizë të bujqësisë nga eksperti A.S, ekspertiza e datës 15.10.2019, si dhe sqarimeve të dhëna nga ana e ekspertit A.S në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03.02.2020. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin ekspertizës vlerësuese të bujqësisë, pasi që nga mendimi i ekspertit A.S të dhënë në ekspertizë me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë është vlerësuar profesional, duke vlerësuar se eksperti në fjalë ka dhënë mendim profesional me shkrim dhe real, duke vlerësuar në mënyrë të gjithanshme paluajtshmërinë në fjalë, dhe duke përdorë metoda krahasuese janë marr për bazë të gjitha provat që kanë pasur mundësi të disponon me to eksperti, po ashtu paditësit i është shkaktuar dëm me rastin e shtrimit dhe zgjerimit të rrugës në fshatin

Gjykata e Apelit vlerëson se mendimi i ekspertit ishte i mbështetur në të gjitha elementet, të njëjtat me të drejtë janë vlerësuar të besueshme sepse kanë trajtuar në detaje të gjitha elementet e pronës, dhe ka arritur të një përfundim real i përcaktimit të pronës sikurse është vendos në aktgjykimin e atakuar. Pra me rastin e përpilimit të ekspertizës vlerësuese janë përfillur metodat adekuate dhe krahasuese për të nxjerr çmimin real.

Kjo gjykatë vlerëson se, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, kur ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit sepse edhe vetë e paditura gjatë zhvillimit të procedurës ashtu edhe në ankesë ka theksuar se, asfaltimi i asaj rruge është bërë në tri faza, gjatë viteve 2014-2015 dhe 2016, që do të thotë se nuk e ka kontestuar asfaltimin e asaj rruge, ndërsa sa i përket pretendimit se ajo rrugë është hapur me mjete dhe me vetë iniciativë të banorëve të atij fshati në vitin 1984, kjo nuk e bënë kërkesën e paditësit si të parashkruar për shkak se punimet rreth zgjerimit dhe asfaltimit janë kryer gjatë viteve 2014-2015 dhe 2016, e që padia në gjykatë për kompensimin e dëmit është paraqitur në gjykatë me datë 09.09.2015 pra në afatin e paraparë ligjor.

Gjykata e Apelit, duke u nisur nga kjo gjendje vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke e vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale.

Me dispozitën e nenit 136 i LMD-së parashihet që: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa dispozita e nenit 140 i LMD-së parasheh që: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Në rastin konkret është vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme se e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit, andaj si pasojë e kësaj e njëjta ka për detyrë që ta kompensojë, duke pasur parasysh edhe faktin se ekziston edhe fajësia e të paditurës për shkaktimin e dëmit, në këtë rast kemi të bëjmë me shkaktim të dëmit material ndaj palës paditëse, kjo pasi që e paditura ia merr pjesë të ngastrës lëndore pa proces të shpronësimit, për nevoja të interesit të përgjithshëm përkatësisht për ndërtim të infrastrukturës për nevoja të fshatit, me qrast paditësit i është shkaktuar dëm në vlerën e cila është e përcaktuar me ekspertizë.

Sa i përket lartësisë së dëmit e paditura gjatë procedurës asnjëherë nuk e ka kundërshtuar ekspertizën e gjeodezisë e as ekspertizën për vlerësimin e pronës, ndërsa po ashtu nuk ka

propozuar ekspertizë tjetër, në raport me çështjen në fjalë, andaj Gjykata e Apelit e mbështet qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke e pranuar aktgjykimin e atakuar në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, por të njëjtat nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe.

Ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve, si për përfaqësime ashtu edhe për taksa gjyqësore dhe ekspertiza e gjithashtu është në harmoni me dispozitat e LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.534/2021, me datë 25.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.